

Nr. 02/23

Datë: 14.06.2023

Prishtinë

Në mbështetje të nenit 9 pika 2 dhe të nenit 106 pika 1 të Statutit të Fakultetit të Studimeve Islame (në tekstin e mëtejme FSI), në mbështetje të vendimit nr. 47/22 të Këshillit Mësimor Shkencor të FSI-së, si dhe në mbështetje të vendimit nr. 34/23 të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, FSI miratoi këtë:

RREGULLORE

Për procedurat e inicimit, hartimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat për inicimin, hartimin, përmbajtjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes të Fakultetit të Studimeve Islame dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë, vendore apo ndërkombëtare, si dhe institucioneve të tjera jo arsimore të karakterit jo akademik mirëpo që janë me interes për implementimin e aktiviteteve të përbashkëta ndër-institucionale.

Neni 2

Inicimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit

1. Të drejtën e nismës për inicimin dhe lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit e kanë: Dekani, Prodekani, Udhëheqësi i zyrës për marrëdhënie me jashtë dhe sekretari.
2. Të gjitha nismat për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit, duhet të miratohen nga KMSH (Këshilli Mësimor Shkencor).

Neni 3

Hartimi dhe përmbajtja e marrëveshjeve të bashkëpunimit

1. Teksti dhe përmbajtja e projekt marrëveshjes e hartuar nga personat kompetent të përcaktuar në nenin paraprak, paraprakisht i dërgohen Zyrës për marrëdhënie me jashtë dhe Sekretarit të Fakultetit.
2. Zyra për Marrëdhënie me Jashtë në bashkëpunim me Sekretarin e Fakultetit harmonizojnë tekstin dhe përmbajtjen e projekt marrëveshjes me qëllim të kontrollimit dhe harmonizimit të çështjeve teknike/ ligjore/ formale.
3. Marrëveshjet e bashkëpunimit hartohen në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze ose në ndonjë gjuhë tjetër varësisht nga gjuha zyrtare e palës tjetër.
4. Në të gjitha rastet minimum dy kopje të marrëveshjes së bashkëpunimit mbesin për FSI-në. njëra në Zyrën për marrëdhënie me jashtë dhe tjera në Zyrën e Sekretarit të Fakultetit.

Neni 4

Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit

1. Dekanati dhe Udhëheqësi i Zyrës për marrëdhënie me jashtë, kryejnë të gjitha veprimet e ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve me institucionet jashtë Republikës së Kosovës.
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, nënshkruhen nga Dekani.
3. Në të gjitha rastet e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, zbatohet parimi i reciprocitetit.

Neni 5

Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të bashkëpunimit

1. Në rastet kur nisma për marrëveshje të bashkëpunimit fillon nga FSI, atëherë Dekanati vendos për përbërjen e delegacionit, kohën dhe vendin ku do të zhvillohen negociatat, mbulimin e shpenzimeve dhe çështjet e tjera të ndërlidhura.

2. Në rastet kur nisma për marrëveshje të bashkëpunimit fillon nga institucionet tjera, atëherë një nismë të tillë Udhëheqësi i zyrës për marrëdhënie me jashtë ia prezanton Dekanit dhe Sekretarit dhe vendoset për vazhdim apo mos vazhdim të negociatave.

Neni 6

Përgjegjësitë e Zyrës për marrëdhënie me jashtë


1. Çdo korrespondencë gjatë fazës së negociatave e deri në finalizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë dhe partnerët ndërkombëtarë zhvillohet nga apo përmes Zyrës për marrëdhënie me jashtë.
2. Për çdo përparim të negociatave, udhëheqësi i Zyrës i raporton Dekanit.
3. Zyra për marrëdhënie me jashtë zhvillon një bazë të të dhënave në të cilën duhet të evidentohen të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit me detajet e saja. Qasje të plotë në këtë bazë të të dhënave ka vetëm udhëheqësi i zyrës për marrëdhënie me jashtë dhe Sekretari i FSI-së.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më datën e miratimit të saj nga KMSH dhe aprovimi nga Kryesia BIRK-ut.

Prishtinë,
14.06.2023

DEKANI

Prof. asoc. dr. Islam Hasani